

LIGJ
Nr. 62/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9106, DATË 17.7.2003 “PËR SHËRBIMIN
SPITALOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22
Mbikëqyrja, kontrolli dhe inspektimi

1. Ministria e Shëndetësisë, duke respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit spitalor të qarkut, ushtron mbikëqyrje dhe kontroll mbi autoritetin spitalor të qarkut për cilësinë e shërbimeve në spitale, si dhe kontroll ekonomiko-financiar për pjesën e buxhetit që financon.

2. Kontrolli mbi kontratat me institucionet e ndryshme dhe mbi marrëveshjet me sigurimet shoqërore ushtrohet sipas detyrimeve të përcaktuara në vetë kontratat ose marrëveshjet.

3. Inspektimi për respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik nga spitalet publike dhe jopublike kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.

Neni 2

Në nenin 51, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Procedurat për vendosjen e dënimit administrativ me gjobë dhe ankimin rregullohen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8021, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani